  16. Prasad MM, Cheng EY. Imaging studies and biomarkers to detect clinically meaningful vesicoureteral reflux. *Clin Urol* 2017;58 Suppl 1:S23-31.
  17. Wu HY, Shortliffe LD. Top-down approach for evaluation of urinary tract infection. *Urology* 2010;75:514-5.
  18. Kjeldsen L, Johnsen AH, Sengeløv H, Borregaard N. Isolation and primary structure of NGAL, a novel protein associated with human neutrophil gelatinase. *J Biol Chem.* 1993;268: 10425-32.
  19. Schmidt-Ott KM, Mori K, Li JY, Kalandadze A, Cohen DJ, Devarajan P, Barasch J 2007 Dual action of neutrophil gelatinase-associated lipocalin. *J Am Soc Nephrol* 18: 407-413.
  20. Schmidt-Ott KM, Mori K, Kalandadze A, Li JY, Paragas N, Nicholas T, Devarajan P, Barasch J 2006 Neutrophil gelatinase-associated lipocalin-mediated iron traffic in kidney epithelia. *Curr Opin Nephrol Hypertens* 15: 442-449.
  21. Kuwabara T, Mori K, Mukoyama M, Kasahara M, Yokoi H, Saito Y. et al. Urinary neutrophil gelatinase-associated lipocalin levels reflect damage to glomeruli, proximal tubules, and distal nephrons. *Kidney Int.* 2009;75:285-94.
  22. Sise ME, Forster C, Singer E, Sola-Del Valle D, Hahn B, Schmidt-Ott KM. et al. Urine neutrophil gelatinase-associated lipocalin identifies unilateral and bilateral urinary tract obstruction. *Nephrol Dial Transplant.* 2011;26:4132-35.
  23. Çağla Serpil Doğan, Nevin Semerci Koyun, Gülşah Kaya Aksoy, Bülent Çekiç, Murat Savaş, and Elif Çomak Delayed diagnosis of primary vesicoureteral reflux in children with recurrent urinary tract infections: Diagnostic approach and renal outcomes. *Turk J Urol.* 2018 Nov; 44(6): 498-502.
  24. Ichino M, Kusaka M, Kuroyanagi Y, Mori T, Morooka M, Sasaki H, Shiroki R, Shishido S, Kurahashi H, Hoshinaga K (2010) Urinary neutrophil-gelatinase associated lipocalin is a potential noninvasive marker for renal scarring in patients with vesicoureteral reflux. *J Urol* 183:2001-2007.
  25. Parmaksız G, Noyan A, Dursun H, İnce E, Anarat R, Cengiz N (2016) Role of new biomarkers for predicting renal scarring in vesicoureteral reflux: NGAL, KIM-1, and L-FABP. *Pediatr Nephrol* 31:97-103.
  26. Nickavar A, Safaeian B, Sadeghi-Bojd S, Harah Lahouti, dashti A (2016) Urine neutrophil gelatinase associated lipocalin to creatinine ratio: a novel index for steroid response in idiopathic nephrotic syndrome. *Indian J Pediatr* 83:18-21. Forster CS, Devarajan P (2017) Neutrophil gelatinase-associated lipocalin: utility in urologic conditions. *Pediatr Nephrol* 32:377- 381.

# VLERA PREDIKTIVE E EKZAMINIMIT EKOGRAFIK DHE $\beta$ -HCG NË DIAGNOSTIKIMIN E MOLËS HIDATIFORME NË MISSED ABORTION.

Dr Shk Rozeta Shahinaj, Dr Ana Dhima

Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë" Tiranë

Medicus 2023, Vol. 28 (3): 346-350

## ABSTRACT

**Background:** Early detecting hydatidiform mole in missed abortion is a challenge.

**Objective:** To analyze the sensitivity of detecting hydatidiform mole by pre-evacuation ultrasound examination in missed abortion.

**Methods:** This retrospective observational study. Data on 67 cases with histologically confirmed hydatidiform mole were collected over a 1-year period and analyzed. Data included serum  $\beta$ -hCG level before surgical evacuation, the ultrasound examination findings, and histopathological findings.

**Results:** The median maternal age was 29 years and the range of gestational age was 5 to 16 weeks. The sensitivity of detecting hydatidiform mole in total by ultrasound examination was 23.8%.

There was a difference in the sensitivity of detecting subtypes of hydatidiform mole. The sensitivity of the detection complete mole was 100% whereas the sensitivity of the detection incomplete mole was 17.7%.

The higher  $\beta$ -hCG level was seen in cases with hydatidiform mole, and the sensitivity by  $\beta$ -hCG was higher compared to ultrasound.

**Conclusions:** In this study, we found lower sensitivity of detecting hydatidiform mole by ultrasound in missed abortion.  $\beta$  hCG level was higher in hydatidiform mole than in non-hydatidiform mole in missed abortion. Our study suggests that routine histopathological examination is necessary in missed abortions.

**Keywords:** Hydatidiform mole, Ultrasound,  $\beta$ -hCG, Complete hydatidiform mole, Partial hydatidiform mole

## BACKGROUND

Mola hidatiforme është një nga format më të zakonshme të sëmundjes trofoblastike gestacionale, që prek 0,6-1,1 në 1000 shtatzëni [1].

Afërsisht 10 deri në 15% të rasteve të molës hidatiforme mund të progredojë në molë invazive dhe 2-3% e rasteve mund të shndërrohen në koriokarcinoma. Përveç kësaj, pacientet me molë hidatiforme të mëparshme kanë një rrezik të shtuar për të zhvilluar një shtatzëni të ardhshme me molë hidatiforme.[2]. Prandaj, mola hidatiforme duhet të ndiqet me rigozitet në praktikën klinike.

Deri më sot, ekzaminimi rutinë histopatologjik pas evakuimit është një gold standard për diagnostikimin e molës hidatiforme.[3] Tashmë me rritjen e performancës

së ekzaminimit ekografik, mola hidatiforme mund të zbulohet në kohë para se ajo të zhvillohet në molë invazive ose koriokarcinoma. Studimet e kohëve të fundit sugjerojnë se rreth 40 deri në 56% e molës hidatiforme mund të zbulohen në ekzaminimin ekografik para evakuimit [4,5,6,7]. Megjithatë, kjo shkallë diagnostikimi mund të ndryshojë edhe në varësi të përvojës klinike dhe të llojit të pajisjeve mjekësore. [5,6,7, 8].

Missed abort, ndodh kur një fetus nuk formohet ose vdes, por placenta është ende në rritje dhe vazhdon të prodhojë hormone. Incidenca e missed abortit është afërsisht 1% në total të shtatzënive dhe rreth 80% e rasteve ndodhin në tremujorin e parë. Në përgjithësi shumica e rasteve të missed abortit janë të lidhura me anomali kromozomike,



por një nga shkaqet e tjera të missed abortit në tremujorin e parë është edhe mola hidatiforme. [9]



Figure 1. Pamje e molës hidatiforme complete si "stuhë dëbore".

## METODA

Ky është një studim retrospektiv. Në të u përfshinë 333 paciente me missed abort që u hospitalizuan në Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik 'Mbretëresha Geraldinë' Tiranë, nga 01 Janari 2021 deri në 31 Dhjetor 2021.

Duke u bazuar në protokollin aktual të Spitalit tonë, për çdo produkt të evakuimit uterin kryhet biopsia histopatologjike për të konfirmuar diagnozën. Missed abort diagnostikohet me anë të ekografisë kur konstatohet një dhomëz gestacionale boshe, si dhe një embrion ose fetus pa aktivitet kardiak.

Duke u bazuar në rekomandimet ndërkombëtare, kriteret ekografike për të diagnostikuar diagnostikuar molën hidatiforme totale përfshijnë praninë e një pamje tipike me mikrokiste në brendësi të dhomëzës gestacionale ose në nivelin placentar ose pamje si 'stuhë dëbore'[10]. Pamjet ekografike të molës hidatiforme parciale mund të përfshijnë ndryshime cistike fokale në placentë dhe rritje të diametrit transvers të sakusit gestacional. Në ndryshim nga mola hidatiforme complete, në molën hidatiforme parciale mund të ketë fetus i cili zbulohet me anë të ekografisë. Pavarësisht nga të dhënat e ofruara nga ekografia, duhet të kryhen ekzaminimet histologjike të të gjitha shtatzënive të pasuksesshme për të vërtetuar diagnozën.

Në studimin tonë u studiuan edhe nivelet sasore të  $\beta$ -

hCG të cilat ishin matur 1-2 ditë para evakuimit.


## ANALIZA STATISTIKORE

Gjatë studimit të kartelave u vlerësuan këto variable :mosha e pacientes,mosha gestacionale në javë kur është bërë diagnostikimi dhe evakuimi i kavitetit uterin, të dhënat ekografike (missed abortion dhe molë hidatiforme),niveli serik i  $\beta$ -hCG (i lartë ose i ulët),të dhënat e ekzaminimit histopatologjik (molë totale ,moël parciale dhe jo molë).U llogaritën proporcionet dhe frekuencat e variableve si dhe krahasimi midis variableve të pavarura për të përcaktuar dallimin midis grupeve. Të dhënat u analizuan nëpërmjet programit Social Science Statistic on line.

## REZULTATET


Gjatë periudhës së studimit, nga 980 aborte gjithsej, në studim u përfshinë 333 paciente me missed abort në tremujorin e parë. Prej tyre janë evidentuar 67 paciente (20.1%) raste me molë hidatiforme të vërtetuara me anë të analizës histopatologjike. Të dhënat demografike për gratë me molë hidatiforme janë përmbledhur në Grafikon 1. Mosha e pacienteve të diagnostikuara me molë hidatiforme varion nga 17 deri në 46 vjec.

Tabelë nr.1. Karakteristikat demografike të popullatës në studim.




Grup mosha më e shpeshtë e pacienteve me molë hidatiforme ishte nga 29-34 vjec (23 raste), pasuar nga mosha 23-28 vjec, kurse më rrallë kjo diagnozë u konstatua në grupmoshat 17-22 vjec dhe 41-46 vjec.

Grafik nr 2. Moshja e shtatzënise kur është vendosur diagnoza e molës hidatiforme.



Në Grafikun nr.2 janë paraqitur moshja gestacionale kur është diagnostikuar mola dhe është kryer evakuimi i saj. Gjatë studimit rezultoi që moshja gestacionale më e shpeshtë kur është vendosur diagnoza dhe u krye evakuimi ishte nga 8 deri 10 javë pasuar nga moshja gestacionale 5 deri 7 javë, kurse kjo diagnozë u konstatua më pak në moshat 11-13 javë dhe 14-16 javë.

Në këtë studim u analizua edhe niveli serik i  $\beta$ -hCG i matur në 1 deri 2 ditë përpara se të kryhej evakuimi, në raport me javët e shtatzënisë. Rezultoi që niveli më i lartë i  $\beta$ -hCG ishte në grup moshën e shtatzënisë 8 deri 10 javë, pasuar nga moshja e shtatzënisë 5 deri 7 javë, kurse në moshat e shtatzënisë 11-13 javë dhe 14-16 javë këto nivele ishin më të ulta. Në grafikun nr.3. janë paraqitur në mënyrë skematike shpërndarja e nivelit serik të  $\beta$ -hCG sipas javëve të shtatzënisë.



Në analizën e të dhënave ekografike në studim rezultoi që diagnoza e molës hidatiforme ishte vendosur në 16 raste ose në 24% të numrit total të molave të vërtetuara nga biopsia, kurse në 76 % të rasteve me mole hidatiforme, diagnoza ekografike ishte missed abort.

Grafik 4. Diagnostikimi me anë të ekografisë i molës hidatiforme në popullatën në studim.





Tabela 1. Frekuenca e molës hidatiforme të plotë dhe të pjesshme në popullatën në studim.

Tipi histopatologjik i molës hidatiforme	Frekuenca
Mola hidatiforme komplete	5(7.4%)
Mola hidatiforme parciale	62 (92.5%)

Në Tabelën nr.1. pasqyrohet shpërndarja e molës hidatiforme sipas klasifikimit histopatologjik në molë të pjesshme dhe në molë të plotë. Nga studimi rezultoi që 7.4% e nr total të molave hidatiforme të vërtetuara me anë të ekzaminimit histopatologjik ishin mola totale, kurse 92,5% ishin mola parciale.

Gjatë shqyrtimit të të dhënave rezultoi që në molën hidatiforme të plotë niveli i  $\beta$ -hCG ishte i rritur në të gjitha rastet kurse në molën hidatiforme jo të plotë vetëm në 4 prej tyre u konstatuan nivele të larta të  $\beta$ -hCG në lidhje me moshën e barrës.



## DISKUTIM

Mola hidatiforme është një nga shkaqet e missed abortit dhe shumica e molave hidatidiforme shfaqen si abort spontan [9]. Në këtë studim vëzhgues retrospektiv gjatë një periudhe 1-vjeçare, u analizuan kartelat e 980 pacienteve që u paraqitën me simptoma aborti. Në 333

prej tyre ishte vendosur diagnozë ekografike missed aborti. Rezultoi se incidenca e molës hidatiforme në missed abort ishte 20.1%, kurse në raport me numrin e aborteve në total ishte 6.8 %.

Në studimin e tyre Omarov dhe Biscaro gjetën një incidencë të missed abort në raport me numrin e aborteve në total rreth 2.6 deri në 9.4% [11, 12]. Kurse Tasci e bp dhe Jauniaux e bp raportuan se incidenca e molës hidatidiforme në missed abortin ishte nga 4 në 56% [13,14].

Të dhënat tona sugjerojnë se 20.1% e rasteve të diagnostikuar me missed abort mund të jenë për shkak të molës hidatidiforme].

Me rritjen e performancës së ekzaminimit ekografik rutinë në tremujorin e parë të shtatzënisë, një numër studimesh raportojnë se afërsisht 40-50% e molës hidatidiforme janë të zbulueshëm [14]. në ekzaminimin ekografik para evakuimit [4,5,6,7], sepse fals pozitiviteti në diagnozën e molës hidatidiforme nga ekzaminimi ekografik është relativisht mjaft i ulët (më pak se 10%) [7].

Në studimin tonë, ne kemi gjetur ndjeshmërinë e zbulimit të molës hidatiforme nga ekzaminimi me ultratinguj në missed abort më të ulët se në studimet e raportuara në literaturë ,23.8 % kundrejt 40-50%. Dallimi në sensitivitetin e zbulimit të molës hidatidiforme në studimin tonë me në atë të studimeve të tjera, mund të jenë sepse në studimin tonë rreth 40% e rasteve me molë hidatiforme i përkisnin tremujorit të parë, ku edhe vecoritë e molës hidatiforme janë më pak të shprehura ndërsa në studime të tjera, diapazoni i moshës gestacionale ishte 5 deri në 27 javë. [5,6,7].

Mola hidatidiforme ka dy lloje histologjike duke përfshirë molën hidatiforme të plotë dhe molën hidatidiform të pjesshme. Në studimin tonë u evidentuan 5 raste (7.4 %) me molë hidatiforme komplete dhe 62 raste (92.5 %) me molë hidatiforme inkomplete.

Studimet raportojnë se ekzaminimi ekografik është më pak i saktë në molën hidatidiforme të pjesshme krahasuar me molën hidatidiforme të plotë [4, 5, 15], sepse tiparet e molës hidatiforme të pjesshme mund të mos jenë të pranishme në tremujorin e parë. Po kështu në studimin tonë të gjitha rastet me molë hidatiforme të plotë ishin diagnostikuar edhe me anë të ekografisë, kurse përsa i përket molës hidatiforme të pjesshme vetëm 17.7% e rasteve të saj u diagnostikuan me anë të ekzaminimit ekografik.

Meqënëse në molën hidatidiforme niveli serik i  $\beta$ -hCG

është më i lartë ,vlerat e larta të tij janë një ndër kriteret për vendosjen e diagnozës. Studimi ynë raportoi nivel më të lartë  $\beta$ -hCG në molën hidatiforme, krahasuar me missed abortin pa molë hidatiforme. Gjatë shqyrtimit të të dhënave rezultoi që në molën hidatiforme të plotë niveli i  $\beta$ -hCG ishte i rritur në të gjitha rastet kurse në molën hidatiforme jo të plotë jo në të gjitha rastet u konstatuan nivele të larta të  $\beta$ -hCG. Berkowitz dhe Goldstein kanë raportuar se më shumë se 40% e pacienteve me molë hidatiforme kishin vlera të  $\beta$ -hCG më të larta se 100.000 UI/L duke sugjeruar përdorimin e  $\beta$ -hCG si një mjet depistues për diagnostikimin e molës hidatiforme në missed abort [1].

Gjithashtu në studimet e tij Jauniaux referoi se marrja në konsideratë e niveleve të larta të  $\beta$ -hCG është një ndihmës i dobishëm për histopatologjinë në tremujorin e parë[16,17]

## KONKLUZIONE

Ekzaminimi ekografik ka rol të rëndësishëm në diagnostikimin e molës hidatiforme në paciente me missed abort. Megjithatë për shkak të shkallës jo të lartë të sensitivitetit të vendosjes së diagnozës së molës hidatidiforme nga ekzaminimi ekografik në rastet me missed abort, rekomandohet që ekzaminimi histopatologjik i materialeve të abortit duhet të kryhet në mënyre rutine pas evakimit të kavitetit uterin. Në këtë mënyrë bëhet i mundur diagnostikimi dhe menaxhimi i duhur i rasteve me molë hidatiforme.

## BIBLIOGRAFIA

1. Berkowitz RS, Goldstein DP. Current management of gestational trophoblastic diseases. *Gynecol Oncol.* 2009;112(3):654-62.
2. Sebire NJ, Fisher RA, Foskett M, Rees H, Seckl MJ, Newlands ES. Risk of recurrent hydatidiform mole and subsequent pregnancy outcome following complete or partial hydatidiform molar pregnancy. *BJOG.* 2003;110(1):22-6.
3. Fram KM. Histological analysis of the products of conception following first trimester abortion at Jordan University hospital. *Eur J Obstet Gynecol Reprod Biol.* 2002;105(2):147-9.
4. Johns J, Greenwold N, Buckley S, Jauniaux E. A prospective study of ultrasound screening for molar pregnancies in missed miscarriages. *Ultrasound Obstet Gynecol.* 2005;25(5):493-7.

5. Sebire NJ, Rees H, Paradinas F, Seckl M, Newlands E. The diagnostic implications of routine ultrasound examination in histologically confirmed early molar pregnancies. *Ultrasound Obstet Gynecol.* 2001;18(6):662-5.
6. Kirk E, Papageorghiou AT, Condous G, Bottomley C, Bourne T. The accuracy of first trimester ultrasound in the diagnosis of hydatidiform mole. *Ultrasound Obstet Gynecol.* 2007;29(1):70-5.
7. Fowler DJ, Lindsay I, Seckl MJ, Sebire NJ. Routine pre-evacuation ultrasound diagnosis of hydatidiform mole: experience of more than 1000 cases from a regional referral center. *Ultrasound Obstet Gynecol.* 2006;27(1):56-60.
8. Benson CB, Genest DR, Bernstein MR, Soto-Wright V, Goldstein DP, Berkowitz RS. Sonographic appearance of first trimester complete hydatidiform moles. *Ultrasound Obstet Gynecol.* 2000;16(2):188-91.
9. Hassold TJ. A cytogenetic study of repeated spontaneous abortions. *Am J Hum Genet.* 1980;32(5):723-30.
10. Woo JS, Hsu C, Fung LL, Ma HK. Partial hydatidiform mole: ultrasonographic features. *Aust N Z J Obstet Gynaecol.* 1983;23(2):103-7.
11. Omarov MA, Magomedov YI. Diagnosis and treatment of missed abortion. *Akush Ginekol.* 1983;5(5):57-9.
12. Biscaro A, Silveira SK, Locks Gde F, Mileo LR, da Silva Júnior JP, Pretto P. Frequency of hydatidiform mole in tissue obtained by curettage. *Rev Bras Ginecol Obstet.* 2012;34(6):254-8.
13. Tasci Y, Dilbaz S, Secilmis O, Dilbaz B, Ozfuttu A, Haberal A. Routine histopathologic analysis of product of conception following first-trimester spontaneous miscarriages. *J Obstet Gynaecol Res.* 2005;31(6):579-82.
14. Jauniaux E. Ultrasound diagnosis and follow-up of gestational trophoblastic disease. *Ultrasound Obstet Gynecol.* 1998;11(5):367-77.
15. Lindholm H, Flam F. The diagnosis of molar pregnancy by sonography and gross morphology. *Acta Obstet Gynecol Scand.* 1999;78(1):6-9.
16. Jauniaux E, Memtsa M, Johns J, Ross JA, Jurkovic D. New insights in the pathophysiology of complete hydatidiform mole. *Placenta.* 2018;62:28-33.
17. Jauniaux E. Partial moles: from postnatal to prenatal diagnosis. *Placenta.* 1999;20(5-6):379-88.018;26(3):153-9.

# URS-SM PROCEDURE USING PNEUMATIC LITHOTRIPTOR FOR THE MANAGEMENT OF URETERAL STONES-OUR EXPERIENCE

Xh. Çuni<sup>1,2</sup>, S. Mehmeti<sup>2</sup>, A. Neziri<sup>2</sup>, A. Ndoj<sup>2</sup>, N. L. Selmani<sup>2</sup>

<sup>1</sup>College "Universum", Prishtine

<sup>2</sup>Clinic of Urology, Prishtine

Correspondent author

Donat Çuni

Email: donatcuni@gmail.com

Medicus 2023, Vol. 28 (3): 351-353

## ABSTRACT

**Introduction:** We assessed the effectiveness of URS-SM procedure for ureteral stones located in different parts of ureter and to determine outcomes of the success rate, complications, and operation time.

**Methods:** After obtaining approval of the Institutional Clinical Board of urology, we reviewed data of consecutive 102 patients treated at our Urology Department with URS-SM procedure in cohort study January 2023-May 2023.

**Results:** There were 44 (43,2%) men and 58 (56,8%) women with a mean age of 43.7 (range 7-78) years old. Most patients had stone on left side 46 ppts (52%), 39 ppts. on right side (38,2%) and on both sides in 10 ppts. (9.8%). The overall success rate after session of URS-SMs was 87,3%. Postoperative complications we had only in one case, urosepsis in a diabetic old man (75 years). Operation time was 36 ( $\pm$  13) min.

**Conclusions:** The URS-SM procedure is an effective treatment with a low rate of complications.

## INTRODUCTION

Ureteral calculi are common, affecting more than 12% of the population and can have a serious impact on one's life and work. The likelihood of spontaneously passing a ureteral stone is largely dependent upon the size and location of calculi [1]. Ureteroscopy (URS) is a preferred method for the treatment of small- to medium-sized kidney stones located in any part of the urinary tract [2]. Ureteroscopic pneumatic lithotripsy (URS) treatment is another technique increasingly used to remove ureteral calculi, especially distal calculi. The success rate of semirigid URS was shown to be higher for proximal than for distal stones [3]. By some authors Librenjak

and Aboutaleb the URS has also been reported as a safe procedure with a success rate of 80% in the removal of proximal ureteral stones and with a higher success rate in patients with smaller than larger stones. Experience and skill are necessary to perform URS [4]. We assessed the effectiveness of URS-SM procedure in ureteral stones performed in our single center and to determine our outcomes of success rate, postoperative complication rate and operation time.

## MATERIALS AND METHODS

After obtaining approval of the Institutional Clinical Board of urology, we reviewed data of consecutive 102

patients treated by URS-SM procedure in our Urology Department, in cohort study January 2023-May 2023. The procedure was performed by all urologists in our hospital (Clinic of urology, Prishtina).

The inclusion criteria in our study were patients with confirmed ureteral stones by radiological investigations, with refractory ureteric stone after failed conservative management), with selected suitability for URS treatment and all patients were informed in advance about the risks of the procedure and gave their consent.

URS-SM procedure was performed in all patients, in the lithotomy position under spinal anesthesia and only in one case (child 7 years old) was used general anesthesia. In all cases was using rigid ureteroscope and pneumatic lithotripter.

## RESULTS

There were 44 (43,2%) men and 58 (56,8%) women with a mean age of 43.7 (range 7-78) years old. Most patients had stone on left side 46 ptt (52%), 39 on right side (38,2%) and on both sides 10 (9.8%). The mean stone size was 8,7 (range 7,5-12) mm. Majority of the stones treated were from the lower ureter 62 ptt (60,7%). Operation time was 36 ( $\pm$  13) min.

The overall success rate was 87,3%.




Fig.1. Image from ureteroscopy




Fig.4. Image from URS-SM procedure

The most common cause of this procedure's failure was in 12 ptt (13%), for stone migration in 11 ptt and in one case who had ureteral orifice oedema. In the case with distal ureteral stone who had ureteral orifice oedema the URS-SM procedure failed and was applied only a DJ stent 4,7 ch. Transient hematuria was observed in some treated patients, which resolved within a few hours. Postoperative complications 1 case (0,9%), urosepsis in one a diabetic old man (75 years) with DM type 1, even he was for three days under antibiotic therapy in Clinic of Infective Disease. The mean hospital stay was 1.6 (range 1-5) day.

All the patients after URS-SM procedure we recommended to drink more than 2 liters of fluids daily throughout the day to check the spontaneous elimination of stones fragments.

Radiologic investigations were performed in routine on 5-10 days postoperatively to confirm the stone-free status (SFR).

## DISCUSSION

Ureteroscopy is the most frequently performed procedure worldwide by urologists

European Association of Urology/American Urological Association Collaborative Guidelines Project Updates reported that SFR varied between 79% and 97% in relation with the stone location in URS used for treating ureteral calculi [5].

Despite the great popularity during the application of the URS-SM procedure, we must be careful in protecting patients from complications that may occur during and after the operation.

There are various reports regarding the potential for complications during the implementation of the URS-SM procedure. The overall rate of complications after URS was reported as 9-25% in the literature [6].

There are data according to a meta-analysis study, which investigated the learning curve of URS, to increase the stone-free rate and reduce operative and postoperative complications it was necessary for the surgeon to have performed more than 50 cases in a high volume center [7].

These data inform us that the experience of urologists in the field of endourology is an important factor.

Although the interventions were carried out by different

teams of urologists in our Clinic, the experience of more than 5 years of the participating urologists influenced in the success of the treatment. All these factors positively influenced our procedure so that the rate of complications was only one case (0.9%)

Stone-free rate (SFR) to be 87.3% and the duration of the operation was 36 ( $\pm$ 13) min.

The experience of participating urologists during the application of the URS-SM procedure has been followed with attention by urology residents and we are sure that this affects their proper education in this field of endourology.

## CONCLUSION

Although our study had a retrospective design, it clearly reconfirmed that the technological development of endourological equipment (URS-SM procedure) and the experience of urologists were key factors in achieving this presented result. Based on the fact that most of the urologists who participated in the performance of the URS-SM procedure were candidates who had completed specialization in our Clinic and who were trained in several European endourological centers, this led to satisfactory treatment results. We are grateful to the European Association of Urology (EAU) and the Turkish Association of Urology (TAU) for the training of our urologists.

## Footnotes

**Informed Consent:** Written informed consent was obtained from patients who participated in this study.

**Conflict of Interest:** No conflict of interest was declared by the authors.

**Financial Disclosure:** The authors declared that this study has received no financial support.

## REFERENCES

1. Optimal management of large proximal ureteral stones (>10 mm): A systematic review and meta-analysis of 12 randomized controlled trials Shicong Lai, Binbin Jiao, Tongxiang Diao, Samuel Seery, Maolin Hu, Miao Wang, Huimin Hou, Jianye Wang, Guan Zhang, Ming Liu.
2. <https://patients.uroweb.org/videos/ureteroscopy-urs-video/>
3. Ur Rehman M, Adnan M, Hassan A, et al. (April 26, 2020) Comparison of Ureteroscopic Pneumatic Lithotripsy

- and Extracorporeal Shock Wave Lithotripsy for Proximal Ureteral Calculi. *Cureus* 12(4): e7840. doi:10.7759/cureus.7840.
4. Ur Rehman M, Adnan M, Hassan A, et al. (April 26, 2020) Comparison of Ureteroscopic Pneumatic Lithotripsy and Extracorporeal Shock Wave Lithotripsy for Proximal Ureteral Calculi. *Cureus* 12(4): e7840. doi:10.7759/cureus.7840
5. Dretler SP. An evaluation of ureteral laser lithotripsy: 225 consecutive patients. *J Urol.* 1990;143:267-72.
6. Geavlete P, Georgescu D, Nita G, Mirciulescu V, Cauni V. Complications of 2735 retrograde semirigid ureteroscopy procedures: a single-center experience.
7. Skolarikos A, Gravas S, Laguna MP, Traxer O, Preminger GM, de la Rosette J. Training in ureteroscopy: a critical appraisal of the literature. *BJU Int.* 2011;108:798-805.

# PREEKLAMPSIA GJATË SHTATZËNISË: NJË STUDIM NDËR SEKSIONAL

Edlira Bylykbashi<sup>1</sup>, Erjona Abazaj<sup>1,2</sup>

<sup>1</sup>University of Medicine, Faculty of Technical Medical Science, Tirana Albania

<sup>2</sup>Institute of Public Health, Tirana, Albania

Corresponding author: abazajerjona@gmail.com

Medicus 2023, Vol. 28 (3): 354-360

## ABSTRACT

**Hyrje:** Preeklampsia konsiderohet si një sëmundje specifike gjatë shtatzënisë që zakonisht shfaqet pas javës së 20-të të shtatzënisë. Ky studim ka për qëllim të vlerësonim se si është situata epidemiologjike dhe cilët faktorë ndikojnë më së shumti në shfaqjen e preeklampsisë tek nënat shtatzëna.

**Metoda:** Ky është një studim ndër-seksional, me përfshirjen e 532 grave shtatzëna të cilat janë ndjekur pranë klinikës Bylykbashi për mbarëvajtjen e shtatzanisë s'ëtyre. Për secilën pjesmarrëse u plotësua një pyetësor mbi informacionet socio-demografike, stilin e jetës, të dhënat antropometrike, të dhënat klinike etj. Softëare IBM SPSS Statistics 26.0 u përdor për analizën e të dhënave. Statistikat përshkruese u përdorën për variablat sociodemografikë. Për të përcaktuar lidhjen ndërmjet të dhënave sociodemografik dhe preeklampsisë u përdorën T-testet dhe testet ANOVA të njëanshme. Testi  $\chi^2$  është përdorur për të krahasuar të dhënat kategorike. Analiza e regresionit logjistik u krye për të identifikuar faktorët që lidhen me preeklampsinë. Vlerat e  $P < 0.05$  u konsideruan statistikisht të rëndësishme.

**Rezultatet:** Prevalenca e përgjithshme e preeklampsisë ishte 14.09%. Rreth 56% e shtatzënive u zbulua se kishin preeklampsi preeklamsi të hershme dhe 44% preeklamsi të vonshme. Faktorët më predispozues të preeklampsisë rezultuan moshë mbi 31 vjeç e shtatzanisë, të jetuarit në zona rurale, edukim I ulët, të ardhura të ulta, të qenurit obezë përpara fillimit të shtatzanisë, apo fitimi i një peshe shumë të lartë gjatë shtatzanisë, hereditetin si dhe mungesa e një aktiviteti fizik të vazhdueshëm si edhe konsumi i duhanit para shtatzanisë. Në të gjitha rastet e përmendura vihet re një lidhje e fortë sinjifikantë si për preeklampsinë e hershme dhe të vonshme për vlerë të  $p < 0.05$ .

**Përfundime:** Prevalenca e rasteve me preeklamsi rezultoi relativisht e lartë krahasuar me mesataren e europës. Nisur nga këto gjetje, këshillohet diagnoza e hershme dhe menaxhimi i menjëhershëm i rasteve me preeklamsi, për të parandaluar të gjitha outcomet që lidhen sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë e lidhur me preeklampsinë si për nënën ashtu edhe për fetusin.

**Fjalë kyçe:** preeklamsi, grua shtatzënë, faktorë rrisht, prevalencë

## INTRODUCTION

Obeziteti para shtatzënisë dhe shtimi i peshës gestacionale (Gestational Weight Gain, GWG) gjatë shtatzënisë së një gruaje, luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e preeklampsisë dhe hipertensionit (1). Preeklampsia konsiderohet një sëmundje specifike që zakonisht ndodh pas javës së 20-të të shtatzënisë (2). Nga gratë që fillimisht

paraqesin hipertension të dukshëm gestacional, rreth një e treta zhvillon sindromën e preeklampsisë dhe eklampsisë. Si të tillë, këta pacientë duhet të vëzhgohen me kujdes për këtë progres. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, presioni i lartë i gjakut ndodh në 1 në çdo 12 deri në 17 shtatzëni tek gratë e moshës riprodhuese nga 20 deri në 44 vjeç (3,4).



Prevalenca e obezitetit tek gratë të cilat jetojnë në rajonin e europës varion nga 10-25%, për këtë arsye, rreziku i preeklampsisë pritet të rritet në mënyrë proporcionale me rritjen e indeksit të masës trupore (Body Mass Index BMI) së këtyre grave. Prevalencë më e ulët e preeklampsisë, vihet re tek gratë të cilat kanë një peshë normale ose tek gratë nën peshë (5). Në mbarëbotën është vlerësuar se deri në 8% e të gjitha grave shtatzëna të jenë të prekura nga preeklampsia. Kjo sëmundje me një prevalencë të konsiderueshme ka ndikim në sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë e nënave dhe foshnjave (6). Sipas një raporti të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, ndërmytet viteve 2003-2009, çrregullimet hipertensive gjatë shtatzënisë ishin shkaku i dytë i drejtpërdrejtë i vdekjes së nënave në mbarëbotën, duke e çuar vdekshmërinë e tyre deri në 14% (7).

Ekzistojnë shumë faktorë të rrezikut metabolik të nënës të cilat rrisin rrezikun për një preeklampsi të hershme apo/dhe të vonshme (8). Rritja e stresit oksidativ dhe stimulimi inflamator sistematik ndodh nga një BMI e rritur para shtatzënisë dhe GWG gjatë shtatzënisë. Kjo rritje dhe stimulim mund të përshpejtojë dëmtimin e qelizave endoteliale të enëve të gjakut. Ky dëmtim në hapat e fundit, rezulton si me shfaqjen e preeklampsisë ashtu dhe me shfaqjen e hipertensionit (9,10).

Në vendin tonë, janë bërë disa studime të cilat kanë hedhur dritë mbi situatën e preeklampsisë në mesin e grave shtatzëna, por këto studime janë kryer pothuajse para 1 dekadë (11,12). Nisur nga mungesa e informacionit për vitet e fundit në lidhje me preeklampsinë tek gratë shtatzëna në ndërmorrëm këtë studim, në mënyrë që të vlerësonim se si është situata epidemiologjike dhe cilët faktorë ndikojnë më së shumti në shfaqjen e preeklampsisë tek nënat shtatzëna.

## MATERIALI DHE METODA

### 2.1 Vendi ku u bë ndjekja dhe mbledhja e të dhënave për gratë shtatzëna

Për realizimin e këtij studimi, u përdor klinika Bylykbashi e cila është një klinikë private me më shumë se dy dekada përvojë në fushën e ndjekjes dhe trajtimit të shtatzënisë. Specialistët e klinikës kanë njohuri të gjera në fushën e obstetrikës dhe gjinekologjisë. Përgjatë një viti pranë kësaj klinike kryehen shumë konsulta që lidhen me fushën e gjinekologjisë si dhe bëhet ndjekja dhe trajtimi i shumë grave shtatzëna, deri në muajt e fundit të shtatzënisë.

### 2.2 Popullata e marrë në studim

Në këtë studim kemi siguruar të dhëna të grave shtatzëna që kanë zgjedhur klinikën Bylykbashi për kujdes prenatal gjatë katër viteve (tetor 2018-shtator 2022).

Kriteret përfshirë të këtij studimi ishin të gjitha gratë shtatzëna të moshës  $\geq 18$  vjeç që nuk kishin një histori të mëparshme të hipertensionit dhe preeklampsisë. Një kërkesë tjetër ishte pranimi i ndjekjes së plotë të shtatzënisë në klinikën tonë, në mënyrë që ndjekja e tyre në lidhje me hipertensionin dhe preeklampsinë të ishte sa më e plotë. Kriteret e përjashtimit ishin gratë që kishin ndërprerë shtatzëninë në kohën e studimit dhe ato që refuzuan të marrin pjesë.

Përgjatë periudhës së përcaktuar u paraqitën në këtë qendër rreth 1019 gra shtatzëna. Pas kontaktit të parë që ne kryem me këto gra, fillimisht ju bëftesa dhe ju shpjegua arsyeja e studimit dhe kushtet që ato duhet të plotësonin si pjesëmarrëse të këtij studimi. Pas refuzimit të ftësën tonë dhe pas përjashtimit të grave me hipertension kronik ekzistues para shtatzënisë, madhësia përfundimtare e kampionit ishte 618 pjesëmarrëse.

Në përfundim, pas tërheqjes në muajt në vijim të 57 gra që fillimisht pranuan të ishin pjesë e studimi si edhe 29 gra të cilat patën ndërprerje të shtatzënisë për arsye të ndryshme patologjike, u arrit në një numër rreth 532 gra shtatzëna. Të gjitha këto gra shtatzëna kanë plotësuar të gjitha kriteret e këtij studimi dhe për pasojë u ndoqën deri në fund të shtatzënisë nga stafi ynë mjekësor.

Pasi ju morr pëlqimi për secilën grua u plotësua një pyetësor i standardizuar dhe i strukturuar nag ana jonë. Pjesët përbërëse të pyetësorit ishin të dhëna të përgjithshme socio-demografike, të dhëna të historisë mjekësore dhe shtatzënisë, të dhëna për stilin e jetesës, etj. Pas ndjekjes disa mujore në fund të procesit të shtatzënisë, rreth 75 shtatzëna u diagnostikuan me preeklampsi.

Preeklampsia u përkufizua si hipertension (dy matje të ndara të presionit të gjakut  $\geq 140/90$  mmHg të marra të paktën 6 orë nga njëra tjetra) dhe proteinuri ( $\geq 1+$  në testin dipstick në dy mostra të urinës ose  $\geq 300$  mg proteina në një mostër të urinës 24 orëshe) pas 20 javë të shtatzënisë.

### 2.3 Analiza statistikore e të dhënave

Të dhënat fillimisht u hodhën në eksel dhe më pas u analizuar duke përdorur softuerin statistikor IBM SPSS Statistics 26.0. Statistikat përshkruese u përdorën për variablat sociodemografikë. Këto variabla u paraqitën në frekuenca, përqindje, mesatare dhe deviacion standard

( $\bar{x} \pm s$ ). Për të përcaktuar lidhjen ndërmjet të dhënave sociodemografik dhe preeklampsisë u përdorën T-testet dhe testet ANOVA të njëanshme. Testi 2 është përdorur për të krahasuar të dhënat kategorike. Ne morrëm në analizë dhe lidhjen ndërmjet preeklampsisë dhe disa prej faktorëve të rrishtit duke përdorur analizën e regresionit logjistik. Vlerat e  $P \leq 0.05$  u konsideruan statistikisht të rëndësishme në këtë studim.

## RESULTS

Në tabelën e mëposhtme kemi paraqitur të dhënat sociodemografike të pjesëmarrësve të përfshirë në këtë studim përgjatë periudhës 4 vjeçare. Kemi bërë një ndarje të të dhënave ndërmjet të gjitha të dhënave të mbledhura nga 532 pjesëmarrëset e këtij studimi dhe grave me preeklamsi. Bazuar në të dhënat e përfutuara, nga 532 gratë shtatzëna që morrën pjesën preeklamsia u vu re në 14.09% të grave shtatzëna. Moshë minimale e të gjitha grave pjesëmarrëse në këtë studim rezultoi 18 vjeç ndërsa moshë maksimale 43 vjeç me një mesatare moshore  $29.4 \pm 5.67$  StD. Ndërsa moshë mesatare e grave me preeklamsi rezultoi  $31.05 \pm 3.7$ , me moshë minimale 23 dhe moshë maksimale 42 vjeç.

Përsa i përket grupmoshës, ne kemi bërë një ndarje ndërmjet grave  $\leq 30$  years old dhe grave  $\geq 31$  years old. Në të gjitha pjesëmarrëset, vihet re një përqindje më e lartë për gratë shtatzëna me moshë  $\leq 30$  years old me afro 64.5% të rasteve dhe një përqindje më e vogël për gratë  $\geq 31$  years old me afro 35.5% të rasteve. E kundërta ndodh tek gratë shtatzëna me preeklamsi ku kemi një predominance të grave me moshë  $\geq 31$  years old me 57.3% të rasteve.

Në lidhje me vendbanimin, në të dyja rastet kemi një mbizotërim të grave të cilat banojnë në zonat urbane me 83.6% për të gjitha pjesëmarrëset dhe 77.3% për gratë me preeklamsi. Përsa i përket nivelit të edukimit të grave pjesëmarrëse një përqindje më e lartë vihet re për ato me edukim more than 12 years of education me 62.2% të rasteve, ndërsa në gratë me preeklamsi vihet re një mbizotërim për gratë me  $\leq 12$  years of education level me 53.1% të rasteve.

Sipas statusit të punësimit, shumica e grave shtatzëna pjesëmarrëse ishin të punësuar në 57.7% të rasteve, ndërsa tek gratë shtatzëna me preeklamsi, shumica e rasteve 39.4% ishin të papuna gjatë shtatzënisë. Pariteti, BMI para shtatzënisë, shtimi i peshës gestacionale dhe herediteti për hipertensionin ose diabetin, luajnë një rol të rëndësishëm në prezencën e preeklampsisë gjatë

shtatzënisë. Bazuar në përllogaritjen e të dhënave, si gratë pjesëmarrëse në total ashtu dhe gratë shtatzëna me preeklamsi, treguan të njëjtin trend rritës të BMI-së dhe shtim në peshë gjatë periudhës gestacionale. Shumica e tyre janë gra multipare dhe kanë një histori të herediteti për hipertensionin dhe diabetin gjithashtu.

Lidhur me situatat e stilit të jetesës, rreth 64,3% e grave shtatzëna nuk kanë aktivitet fizik të përditshëm, dhe 55,1% e grave shtatzëna me preeklamsi. Si përdorues alkoolit u referua vetëm 13.7% të grave shtatzëna në total dhe 15.1% të grave shtatzëna me preeklamsi, ndërsa duhanpirja në 35.15% dhe 30.6% respektivisht.

Table 1. Karakteristikat socio-demografike ne mesin e grave shtatzëna, përgjatë një periudhë studimore 4 vjeçare

Karakteristikat e pjesëmarrësve	Variablat	Të gjitha pjesëmarrëset (532)		Rastet me preeklamsi (75)		P value
		No	%	No	%	
Moshë	$\leq 30$ years old	343	64.5	32	42.7	0.001
	$\geq 31$ years old	189	35.5	43	57.3	
Vendi banimit	Rural	87	16.3	17	22.7	0.5
	Urban	445	83.6	58	77.3	
Niveli i edukimit	$\leq 12$ vite edukim	201	37.8	40	53.1	0.04
	$> 12$ vite edukim	331	62.2	35	46.9	
Statusi i punësimit	Jo	94	17.7	19	25.2	0.007
	Po	307	57.7	26	35.4	
	Nuk punoj gjatë shtatzënisë	131	24.6	30	39.4	
Të ardhura mujore në familje	Më pak se 50.000 leke*	112	21.05	35	47	0.0008
	50.001-100.000 leke*	267	50.2	23	30.6	
	$\geq 100.001$ leke*	153	28.75	17	22.4	
Pariteti	Shtatzani, fëmija i parë	183	34.4	25	34	0.03
	Shumë fëmijë	349	65.6	50	66	
BMI-para-shtatzënisë	Nën peshë	52	9.8	7	9.5	0.0001
	Peshë normale	137	25.7	13	17.7	
	Pre obese	224	42.1	37	49	
	Obese (class I-III)	119	22.4	18	23.8	
Peshë e fituar gjatë periushës gestacionale (GWG)	E pranueshme	194	36.5	11	14.3	<0.0001
	E papërshtatshëm	78	14.7	4	6.1	
	Shumë e tepruar	260	48.8	60	79.6	
Herediteti për hipertension	Jo	319	60	20	27.2	0.02
	Po	213	40	55	72.8	

Diabeti maternal	Jo	458	86.1	61	80.95	0.7
	Po	74	13.9	14	19.05	
Herediteti për diabetes mellitus tip I dhe II	Jo	330	62	56	74.8	0.09
	Po	202	38	19	25.2	
Diabeti gestacional	Jo	463	87	50	67.35	0.002
	Po	69	13	25	32.65	
Aktiviteti fizik para dhe gjatë shtatzënisë	Jo	342	64.3	41	55.1	0.0007
	Po	190	35.7	34	44.9	
Nëse po (34)	Një deri në dy ditë në javë	105	55.3	23	68.2	0.004
	Tre deri në pesë ditë në javë	46	24.2	6	16.7	
	Çdo ditë	39	20.5	5	15.1	
Përdoruese alkoli	Jo	459	86.3	61	80.95	0.001
	Po	73	13.7	24	19.05	
Duhanpirja para shtatzënisë	Jo	345	64.85	52	69.4	0.002
	Po	187	35.15	23	30.6	
Nëse po a konsumoni duhan edhe gjatë shtatzënisë (23)	Jo	144	77	20	86.7	0.001
	Po	43	23	3	13.3	

\*Leke: Monedha Shqiptare

Në tabelën e dytë kemi paraqitur regresionin logjistik ndërmjet disa prej faktorëve të rrezikut dhe preeklampsisë së hershme dhe të vonshme tek gratë shtatzëna. Ne nuk kemi gjetur lidhje domethënëse për BMI para shtatzënisë në kategoritë e nënpeshës, për shtimin e pamjaftueshëm të peshës gestacionale dhe për përdoruesit e alkoolit tek gratë shtatzëna në preeklampsi të hershme dhe të vonshme. Lidhje sinjifikante është gjetur për moshën  $\geq 31$  vjeç, për BMI në kategoritë pre-obezë dhe obezë klas I-III, për peshën e fituar gjatë periudhës gjestacionale me kategoritë e papërshtatshëm dhe shumë e tepruar, hereditetin për hipertension dhe diabet, si dhe për stilin e jetesës si për shëmbull aktivitet fizik dhe konsumi i duhanit para shtatzënisë. Në të gjitha rastet e përmendura vihet re një lidhje e fortë sinjifikantë si për preeklampsisë së hershme dhe të vonshme për vlerë të  $p < 0.05$ .

Tabela 2. Regresioni logjistik ndërmjet disa prej faktorëve të rrezikut dhe preeklampsisë së hershme dhe të vonshme tek gratë shtatzëna

Karakteristikat e pjesëmarrësve	Variables	Early-preeclampsia (42)		Late pre-eclampsia (33)	
		Odds ratio 95%	P value	Odds ratio 95%	P value
Moshë	$\leq 30$ vjeç	reference		reference	
	$\geq 31$ vjeç	1.6 (1.2-1.9)	0.001	1.8 (1.5-2.1)	0.004
Pariteti	Shtatzani, fëmija i parë	reference		reference	
	Shumë fëmijë				
BMI para shtatzënisë	Nën peshë	0.5 (0.02-1.05)	0.75	1.02 (0.6-1.45)	0.5
	Peshë normale	reference		reference	
	Pre obese	1.1 (0.78-1.54)	0.04	1.9 (1.2-2.5)	0.001
Obese (class I-III)		1.4 (0.9-1.81)	0.02	2.4 (1.6-3.45)	0.005
Shtimi në peshë gjatë shtatzënisë	E pranueshme	reference		reference	
	E papërshtatshëm	0.8 (0.04-1.6)	0.2	0.7 (0.2-1.4)	0.1
	Shumë e tepruar	1.3 (0.8-1.9)	0.025	1.8 (1.2-3.4)	0.009
Trashëgimia e hipertensionit	Jo	reference		reference	
	Po	1.4 (1.02-1.9)	0.02	1.6 (0.9-1.9)	0.0001
Diabeti gestacional	Jo	reference		reference	
	Po	0.9 (0.3-1.7)	0.03	1.3 (0.8-1.9)	0.006
Aktiviteti fizik para dhe gjatë shtatzënisë	Jo	2.2 (1.8-2.8)	0.0001	2.5 (1.6-3.07)	0.0008
	Po	reference		reference	
Konsumuese e alkoolit	Jo	reference		reference	
	Po	0.5 (0.01-1.5)	0.08	1.08 (0.6-1.77)	0.06
Konsumimi i duhanit para shtatzënisë	Jo	reference		reference	
	Po	1.03 (0.5-1.81)	0.03	1.4 (0.7-2.1)	0.004

## DISKUTIME

Zhvillimi i hipertensionit dhe proteinurisë pas 20 javësh të shtatzënisë përkufizohet si Preeklampsi (13), e cila prek një numër të konsiderueshëm të grave shtatzënie në mbarë botën (14). Prevalenca e preeklampsisë varion midis 1.8 dhe 16.7% në vendet në zhvillim (15). Komplikimet e lidhura me preeklampsinë dhe shtatzëninë në mbarë botën llogariten në 2% deri në 8%, ndërsa vdekshmëria e nënave në vendet me të ardhura të ulëta rezulton në 9% deri në 26% dhe 16% në vendet me të ardhura të larta (16). Edhe pse janë bërë disa studime në botë, përsëri preeklampsia

ngelet një shqetësim madhor si për nënën, fetusin ashtu edhe për stafin mjekësor që i trajton këto raste.

Në këtë studim shihet një nivel i lartë i preeklampsisë në mesin e grave shtatzëna të marra në këtë studim, në vlerat e 14.09% (75/532). Sipas mendimit tonë, një numër relativisht i lartë i rasteve me preeklamsi, kur mesatarja botërore nuk i kalon 8%, mund të lidhet me kulturën që ekziston ende në vendin tonë, që ushqimi duhet të konsumohet më i bollshëm kur je në shtatzani. Pra, me pak fjalë sipas kësaj mendësie, gjatë shtatzanisë duhet të konsumohet ushqim për dy veta, gjë që përkthehet dhe në outcome të gabuara si për nënën ashtu edhe për fetusin.

Vlen të theksojmë se përqindja që ne gjetëm në këtë studim është e përafërt me një studim të kryer në Bangladesh nga Mao et al, në të cilën prevalenca e përgjithshme e preeklampsisë rezultoi 14.4% në shtatzëni. Sipas këtij grupi studjuesish, kjo prevalencë kaq e lartë lidhet me mos ndërgjegjësimin apo edhe kujdesin e pamjaftueshëm antenatal në zonat rurale (17).

Nga studime të ndryshme është parë se kushtet jo të mira socio-ekonomike dhe mosmarrja apo ndërhyrja me trajtime në mënyrën dhe kohën e duhur mund të shoqërohet gjithashtu me prevalencën e lartë të preeklampsisë në mesin e shumë prej grave shtatzëna (18, 19). Në studimin tonë u gjet që një pjesë e konsiderueshme e kushteve socio-demografike paraqitën një lidhje të fortë sinjifikative me praninë e preeklampsisë në mesin e grave pjesmarrëse të këtij studimi.

Mosha është parë si një nga faktorët më të rëndësishëm të preeklampsisë. Në studimin tonë, gratë mbi 31 vjeç paraqitën një prevalencë më të lartë të preeklampsisë krahasuar me ato nën 31 vjeç me një lidhje të fortë sinjifikative p value=0.001. Edhe vendbanimi paraqiti një lidhje sinjifikantë me preeklampsinë. Kjo gjetje ishte e ngjashme me studimin e mëparshëm (17).

Vlen gjithashtu të theksojmë se një nivel i ulët ekonomik është i lidhur drejtëpërsëdrjti me faktorë të shumtë rreziku për preeklampsinë. Pasi këta faktorë lidhen me çështjet e të ushqyerit, kujdesin e reduktuar para lindjes dhe kushtet josanitare higjienike. Në një studim të kryer nga Gandhi statusi i ulët socio-ekonomik i grave dyfishoi rrezikun e pre-eklampsisë dhe eklampsisë (20). Edhe në studimin tonë ne gjetëm një lidhje të tillë ndërmjet të ardhurave shumë të ulta për një familje dhe zhvillimin të preeklampsisë tek këto gra me p value=0.0008.

Faktorë tjetër i rëndësishëm është dhe statusi i punësimit. Në një studim të kryer në Australi u gjet se gratë që ishin

të punësuar krahasuar me ato që nuk ishin të punësuar kishin një rrezik më të lartë për të zhvilluar pre-eklampsia dhe eklampsia (21). Ky fakt shpesh shpjegohet me stresin që gratë mund të kenë gjatë përditshmërisë së tyre në punë. Ne gjetëm një lidhje sinjifikante për statusin e punësimit dhe preeklampsisë me p value=0.007. Gjithashtu dhe niveli arsimor në studimin rezultoi me një lidhje sinjifikante me preeklampsinë me p value = 0.04, gjë që ishte e ngjashme me studime të tjera që kanë raportuar një lidhje domethënëse ndërmjet arsimimit të nënës, të ardhurave të ulta dhe pre-eklampsisë (20,22).

Preeklampsia njihet si një sindromë heterogjene me patofiziologji të ndryshme dhe ndahet në dy nëntipe sipas fillimit të sëmundjes (23, 24). Sipas një studimi të kryer nga Lisonkova dhe Joseph, incidenca e preeklampsisë me fillimin e hershëm dhe të vonë përlllogaritet përafërsisht në 0.3 dhe 2.7% (25). Në studimin tonë gratë me preeklampsia të hershme rezultuan më shumë se gjysma e grave pjesmarrëse (56%) kundrejt atyre me preeklampsia të vonshme (44%) me ndryshim statistikiqisht të rëndësishëm p value=0.003. Përveç kësaj, disa studime treguan variacione biologjike dhe spektre të ndryshëm të patofiziologjisë midis preeklampsisë me fillimin e hershëm dhe të vonë [18,19,20]. Sipas disa studimeve të tjera, faktorët klinik të lidhur me rrezikun e preeklampsisë së hershme apo të vonshme përfshinin primiparitetin, moshën e avancuar të nënës, preeklampsinë e mëparshme, historinë familjare të preeklampsisë, shtatzëninë e shumëfishtë, obezitetin, racën apo etninë, praninë e diabetit mellitus, hipertensionin kronik, sëmundjet kronike të veshkave etj (24,26,27). Në këtë studim, ne gjetëm që kontribuesit apo faktorët më të rëndësishëm për zhvillimin e preeklampsisë në këtë studim ishin mosha më e madhe se 31 vjeç, të qënurit obezë përpara fillimit të shtatzanisë, apo fitimi i një peshe shumë të lartë gjatë shtatzanisë, hereditetin për hipertension dhe diabet, si dhe mungesa e një aktiviteti fizik të vazhdueshëm si edhe konsumi i duhanit para shtatzanisë. Në të gjitha rastet e përmendura vihet re një lidhje e fortë sinjifikantë si për preeklampsisë e hershme dhe të vonshme për vlerë të p <0.05.

## KUFIZIMET

Edhe pse në këtë studim u munduam të jepnin një situatë aktuale në lidhje me prevalencën e preeklampsisë si edhe identifikimin e disa faktorë të rrishtit të lidhur me këtë patologji kaq të rëndësishme mbarë globale në fushën e obstetrikës, ky studim kishte disa kufizime.

Së pari, madhësia e kampionit në studimin tonë ishte

relativisht e vogël pasi të dhënat për pjesëmarrësit e përfshirë në studim janë marrë vetëm nga rastet e paraqitura pranë klinikës sonë gjë që mund mund të rrisë prevalencën e preeklampsisë.

Së dyti, ne nuk e dimë sa të vërteta janë disa nga përgjigjet e dhëna në lidhje me faktorët e rrishtit për preeklampsinë.

Edhe pse gjetjet tona mund të mos jenë përfaqësuese të të gjithë prevalencës apo incidencës në nivel nacional, përsëri këto gjetje mund të jenë të dobishme për studime të mëtejshme në këtë fushë në vendin tonë.

## PËRFUNDIME

Gjetjet e këtij studimi hedhin dritë mbi faktorët më të rëndësishëm të rrishtit për zhvillimin e preeklampsisë në mesin e grave shtatzëna. Ky studim gjeti se shanset që një grua të ketë pre-eklampsi shoqërohen me moshën kur ndodh shtatzënia, statusin e ulët socio-ekonomik (të banuarit në zonat rurale, të ardhura të ulta, nivel i ulët arsimor), histori familjare të hipertensionit dhe diabetit, aktivitetin fizik të ulët, duhanpirjen etj. Nisur nga këto gjetje, këshillohet diagnoza e hershme dhe menaxhimi i menjëhershëm i rasteve me preeklampsi, për të parandaluar të gjitha outcomet që lidhen sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë e lidhur me preeklampsinë si për nënën ashtu edhe për fetusin. Të palët e intersuara duhet të ndërhyjnë me programe të mirfillta në lidhje me mjekimin e rasteve me preeklampsi, me vizitat antenatale, lindjet dhe shërbimet e kujdesit pas lindjes në mënyrë që reduktohen dhe parandaloen sa më shumë të jetë e mundur të gjitha ngjarjet apo faktorët që ndikojnë drejtëpërsëdrejti në rastet e preeklampsisë.

## REFERENCAT

1. Barton JR, Joy SD, Rhea DJ, Sibai AJ, Sibai BM. The influence of gestational weight gain on the development of gestational hypertension in obese women. *Am J Perinatol.* 2015;32(7):615-9.
2. Lopez-Jaramillo P, Barajas J, Rueda-Quijano SM, Lopez-Lopez C, Felix C. Obesity and Preeclampsia: Common Pathophysiological Mechanisms. *Front Physiol.* 2018 Dec 19; 9:1838. doi: 10.3389/fphys.2018.01838.
3. <https://www.cdc.gov/bloodpressure/pregnancy.htm>
4. Bateman BT, Shaw KM, Kuklina EV, Callaghan WM, Seely EW, Hernandez-Diaz S. Hypertension in women of reproductive age in the United States: NHANES 1999-2008. *PLoS ONE.* 2012;7(4):e36171.
